



Skema e IDEA- Grant në mbështetje të aspirantëve për sipërmarrës

Komisioni i Vlerësimit të Granteve (IGAC) ka përfunduar vlerësimin e aplikuesve për fazën e parë të Skemës “IDEA-Grant”. Në thirrjen e parë, të hapur nga data 01.08.2018 deri në datë 31.08.2018, aplikuan në total 84 aplikues. Prej tyre, 53 aplikues dorëzuan dokumentacion të plotë dhe të rregullt brenda afatit dhe kaluan për vlerësim në Komisionin e Vlerësimit të Granteve (IGAC). Komisioni shpalli 8 fitues dhe 5 të tjerë do të thirren për t’u dëgjuar në lidhje me idetë e prezantuara dhe implementimin e tyre përmes planit të biznesit. Aplikantët që kanë plotësuar dosjen jashtë afatit do të kalojnë për vlerësim në thirrjen e rradhës. Ata që nuk e kanë plotësuar dosjen ende, si dhe të gjithë të tjerët që janë të interesuar, inikurajohen të aplikojnë në thirrjen e rradhës dhe në vazhdim.

